

Shtojca 3**Formulari i kërkesës për vazhdimin e lejes mjedisore**


Emri i kompanisë	„XONI-H” Sh.p.k.
Lloji i veprimtarisë	Thërrmim dhe Seperim të Gurit Gëlqeror
Vendi/lokacioni ku zhvillon veprimtarinë	Zona kadastrale Guriq, komuna Malishevë
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës si dhe vula e kompanisë	z. Egzon Helshani
Adresa	Fshati Banjë pn, komuna Malishevë
Telefoni , fax, e-mail	+383 49 929 960 / +383 44 929 960 xoni-h@outlook.com
Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis	Dr.sc. Edona Kabashi-Kastrati
Adresa	edonak88@gmail.com 049655661, Prishtinë
Përshkrimi i dokumentacionit të bashkëngjitur kërkesës përfshirë numri e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	Çertifikata e Biznesit: 811150804; 20.06.2014 Vendimi për Pëlqim Mjedisor: 4141-2/19; 09.09.2019 Vendimi për Leje Mjedisore; 3788/20; 17.03.2021 Akvendimi i licencimit KPMM: 4211; 10.12.2025 Fletat poseduese; 658/26; dt. 03.04.2026 Kopjet e planit; Situacioni i terrenit;
Deklarimi i vlerës financiare të investimit të projektit (euro), nënshkruar nga personi përgjegjës i kompanisë	90,000.00 euro
Fatura e pagesës se tarifës për vazhdimin e lejes mjedisore	Po
Aplikacioni origjinal i plotësuar për leje mjedisore në një (1) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD).	Po


Shtojca 2
Aplikacion për dhënie e lejes mjedisore


APLIKACION PËR DHËNIEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	„XONI-H” Sh.p.k.
	Vendi	Zona kadastrale Guriq komuna Malishevë
	Adresa	Fshati Banjë pn, komuna Malishevë
	Nr. i tel./fax	+383 49 929 960 / +383 44 929 960
	E-mail	xoni-h@outlook.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	Nr. Biznesit; 811150804 Datë; 20/06/2014
1.1.3.	Personi përgjegjës i kompanisë	Egzon Helshani, Drejtor
	Nr. i tel./fax	+383 49 929 960
	E-mail	xoni-h@outlook.com
1.1.4.	Personi kontaktues përgjegjës për mjedis	Dr.sc. Edona Kabashi Kastrati
	Nr. i tel./fax	+383 49 655 661
	E-mail	edonak88@gmail.com
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	„XONI-H” Sh.p.k. Thërrmim dhe Seperim të Gurit Gëlqeror
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Zona kadastrale Guriq komuna Malishevë

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

2.1.	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	Thërmojsja dhe Sepereacioni “XONI-H“ SH.P.K., me pronar Egzon Helshani nga fshati Banjë komuna e Malishevës është projektuar dhe është ndërtuar në afërsi të drejtëpërdrejtë në rrugën që lidh dy fshatrat Banjë dhe Guriq, duke përfshirë këto koordinata: North - 42°27'9.96", East -20°46'12.49", në fshatin Gajrak, parcela në të cilën është ndërtuar thermojsja- Seperacioni për thyerjen e gurit me certifikatë të pronësisë me numër të lëndës 1037-2019, ndodhet në fshatin Gajrak shfrytëzimi i parcelës është Kullosë, Kullosë e klasit të 3, zona kadastrale Guriq, komuna Malishevë. Pjesë e ngastres katastrale nr. 00049-0, të njësisë kadastrale P-72310015-00049-0.
------	--	---



		
2.2.	Numri kadastral i parcelës	Lokacioni i Thermimit dhe seperimit të gurit gëlqeror ndodhet në pjesën e ngastrës kadastrale nr. P-72310015-00049-0 me sipërfaqe totale 6361 m ² , në zonën kadastrale Guriq, komuna Malishevë.
2.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë	Zona ku zhvillohet aktiviteti i gurthyesit ndodhet në lartësi mbidetare prej 400 m deri në 600 m, në zonën kadastrale Guriq, në territorin e Komunës së Malishevës, në drejtim verilindor, rreth 1,400 m larg nga fshati Banjë (në vijë ajrore). Lokacioni i gurorës është miratuar me vendim të organit kompetent të Komunës së Malishevës. Në afërsi të drejtpërdrejtë të lokacionit nuk janë identifikuar objekte banimi; shtëpitë më të afërta ndodhen në një distancë mbi 800 m. Në zonën përreth operojnë edhe dy gurore të tjera, të cilat ndodhen në distanca që variojnë nga rreth 150 m deri mbi 500 m. Lokacioni ku zhvillohet aktiviteti i thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror ndodhet në lokalitetin e fshatit Guriq, Komuna e Malishevës, në anën e majtë të rrugës që lidh fshatin Banjë me fshatin Kërvasari. Objekti është i vendosur në parcelën kadastrale me numër P-72310015-00049-0. Në afërsi të drejtpërdrejtë të impiantit të thërrmimit dhe separimit nuk gjenden objekte banimi. Objektet e banimit në fshatrat përreth, si

		Kërvasari dhe Guriq, ndodhen në distancë mbi 1 km, ndërsa fshati Banjë ndodhet në një distancë prej rreth 800 m nga lokacioni i projektit. Aktivitetet kryesore në këtë lokacion përfshijnë: • përpunimin e gurit gëlqeror; • thërrmimin dhe separimin e materialit shkëmbor; • transportin e materialit brenda dhe jashtë lokacionit; • funksionimin e pajisjeve dhe stabilimenteve për përpunim dhe de-pluhurim. Zona karakterizohet si zonë me aktivitet industrial-ekstraktiv, me ndikim të kufizuar në zonat e banuara përreth, duke marrë parasysh distancat e konsiderueshme nga vendbanimet. 
2.4.	Të dhëna lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	Bimësia dhe vegjetacioni - Flora Në bazë të shqyrtimeve vizuale të zonës ku kryhet aktiviteti i thermimit dhe seperimit të gurit gëlqeror kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulëta barishtore, manaferra, shkurre kurse ne hapësirën më të gjerë të ngastrës edhe shkozë, qarr, bung, etj. Gjithashtu

		kemi hasur në këtë zone edhe në bimët që u përshtaten kushteve të jetës së tyre në shkëmbinjtë gëlqeror. Ngastrërat në përreth nuk janë të mbjellura me të lashta periodike, por është e mbuluar me kullota, barishte, shkurre dhe manaferra të ndryshme. Ndërsa pjesën e ngastrës ku është vëndosur makineria për therrmim dhe seperim të gurit gëlqeror pronari e ka gërmuar sipërfaqen dhe ka krijuar kaskada/shkallë me sipërfaqe të rrafshhtë për vëndosjen e makinerisë dhe materialit të therrmuar dhe seperuar. Bota shtazore – Fauna Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike si dhe në bazë të të dhënave nga vendasit në këtë zonë përpos kafshëve dhe shpezëve shtëpiake, jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, derri i egër, dhelpra, ujku, iriqi, etj. Prej brejtësve- minjtë, prej zvarranikëve: gjarpërinjtë, breshka e tokës, zhapini i gjelbër etj, nga insektet: mizat, mushkonjat etj. Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: bilbilat, fëllënëzat e fushës, lejleku, etj.
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	Mbrojtja e mjedisit përbën një komponent shumë të rëndësishëm të zhvillimit të qëndrueshëm. Në këtë kontekst, ekzistojnë ligje përkatëse që synojnë mbrojtjen e natyrës dhe parandalimin e degradimit të saj, veçanërisht në zonat e mbrojtura dhe për organizmat e gjallë të mbrojtur me ligj. Duke marrë parasysh llojin e projektit, madhësinë e objektit dhe pozitën e lokacionit ku zhvillon aktivitetin kompania “XONI-H” Sh.p.k., në Banjë, Malishevë, konstatohet se nuk pritet të ketë ndikim negativ në prishjen e peizazhit në zonën e analizuar. Kjo për arsye se lokacioni nuk ndodhet në një zonë të ndërtuar me objekte banimi. Gjithashtu, lokacioni i kompanisë “XONI-H” Sh.p.k., në zonën kadastrale Guriq, Malishevë, ku zhvillohet aktiviteti i thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror, nuk ndodhet brenda një zone të veçantë të mbrojtjes.


3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet leja mjedisore

3.1.1.

Skema e procesit teknologjik

Bashkëngjitur gjeni edhe tek Shtojca 1



3.1.2.

Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik

Përshkrimi i thërmuesit me seperacion dhe pajimeve përcjellëse:

Kompania “XONI-H” Sh.p.k., në zonën kadastrale Guriq, Malishevë, e cila si aktivitet ka thermimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, ka të vendosur thërmuesen me seperacion që përbehet nga këto pajime: Thërmuesja primare me nofulla mobile (vetëlëvizëse), prodhim i vjetër, me kapacitet të thërmimit 33 m³ /h, ka të bashkangjitur bunkerin pranues vëllim prej 20m³, dozatorin me vibrim dhe transportuesit shiritor për bartje të materialit të thërmuar, Thërmuesja sekondare me traj (mulliri), Seperacionin (sitën vibruese e pjerrtë) mobile (vetëlëvizëse), sit vetë lëvizëse dimensionet e sitës 1530x4800mm, kapaciteti i sitjes gjerë në 120 m³/h, si dhe transportuesit shirior për transportimin e materialit të thërmuar dhe të seperuar në deponit adekuate.

Pajisje tjera të cilat përdoren në këtë kompani janë:

Makinë ngarkuese 1 copë

		Bager 1 copë Kamion për transportim 1 copë Procesi teknologjik i thërrmuesit me seperacion Prodhimi në thërrmuesit me seperacion bëhet në bazë të kërkesave të blerësve, në bazë të cilave bëhet edhe plani i biznesit të kompanisë. Prodhimi në thërrmues me seperacion bazohet në prodhimin e fraksioneve për ndërtimin e rrugëve, për agregat betoni dhe agregat asfalti. Në vijim po japim përshkrimin e procesit teknologjik të thërrmueses me seperacion: Guri gëlqeror i shkëputur me anë të lëndëve plasëse, ngarkohet në ballë të kateve të punës me ekskavator ose me ngarkues tjetër. Masa e ngarkuar transportohet me kamionë të veçantë për transportimin e masës shkëmbore. Gabaritet e masës së gurit gëlqeror të cilët ngarkohen në kamion nuk guxojnë të jenë më të mëdhenj se 900 x 710 mm. Guri gëlqeror nga kamionët derdhet në bunkerin pranues (fortina) me kapacitet prej 35 m³ nr, 1, mandej me anë të dhënësit vibrues nr. 2, ushqehet thërrmuesja primare me nofulla nr. 4, e cila ka kapacitet teorik prej 80 m³ në orë, ose kapacitet real prej 40 deri 50m³ në orë. Transportuesi i pjerret shiritor nr. 3, shërben të mënjanoj sterilin nga masa e pastër, në këtë mënyrë bënë pastrimin e gurit gëlqeror që do të trajtohet në thërrmuesen me seperacion dhe të përgatis prodhimin për aplikim në ndërtimtari të ulët dhe të lartë. Nga thërrmuesja primare nofullore nr. 4, përmes dhënësit vibrues nr. 2 guri gëlqeror i thërrmuar kalon ne transportuesit shiritor nr. 3a dhe nr.5, nga ku transportuesi shiritor nr. 3a fraksionin +0-31mm ose +0-60mm e dërgon në deponin adekuate, fraksioni i mbetur + 31mm ose + 60mm përmes transportuesit shiritor nr. 5 dërgohet në thërrmuesen sekondare me çekiça nr.6, që ka kapacitet
--	--	--

		teorik prej 33 m³ në orë, ose kapacitet real prej 33 m³ /h, e cila e bën thërrmimin ma të mirë të shkëmbit dhe e nxjerr madhësinë e nevojshme të fraksioneve për aplikim për prodhim të betonit dhe asfaltit. Thërrmimi i materialit në këtë thërrmuese bëhet sipas dëshirës nga se ka mundësi të rregullimit (për këtë operacion do të jetë e pajisur me mekanizëm të veçantë) prandaj edhe lehët nxirren fraksionet e dëshiruara. Nga kjo thërrmuese me anë të transportuesit shiritor nr.7, materiali transportohet në sitën vibruse nr.8, ku bëhet ndarja në fraksione sipas kërkesave të blerësve. Në sitë sigurisht se mbetet një sasi e cila kalon kufijtë e të kërkuarës (do më than se madhësia e një pjese të kokrrave të fraksionit është më e madhe se vrimat e sitës), prandaj kjo sasi e materialit do të kthehet përsëri me anë të transportuesit shiritor nr.13, në thërrmuesen sekondare numër 6, ku do të bihet në madhësi të fraksioneve të lejuara, dhe kështu e përgatitur së bashku me materialin tjetër me transportier shiritor nr.7, kthehet në sitën vibruese nr. 8, për trajtim të dytë, e po qe se ka nevojë (ajo në mënyrë kontinuale) do të kthehet edhe herëve tjera në thërrmuesen sekondare gjerë sa të fitohet madhësia e fraksioneve që do të kalojnë nëpër rrjeta të sitës. Materiali i trajtuar në sitën nr.8, me anë të transportuesve shiritor nr.9, nr.10, nr.11 dhe nr.12, transportohet në deponit nr.14 të caktuara për fraksione adekuate. Menaxhimi i procesit teknologjik bëhet nga dhoma afër thërrmueses e në të cilën është vendosur ormani me tërë automatiken dhe mbrojtësit për tërë hargjuesit e energjisë elektrike, si dhe pulti komandues i cili është i vendosur në ormanin adekuat të caktuar për te. Automatika është e rregulluar në atë mënyrë që mundëson lëshuarjen në punë të pajimeve të gurthyesit me seperacion në mënyrë automatike dhe manuale. Në pultin komandues ekziston
--	--	---

		rregullatori komandues për zgjedhjen e punës së gurthyesit me seperacion. Nëse zgjedhim punën automatike, atëherë për fillimin e startimit të pajimeve të gurthyesit me seperacion, pajimet lëshohen në punë automatikisht, duke filluar nga më të largëtat kah të afërmet, nga transportierët për fraksionet finale, pasandaj sita vibruese, transportierin shiritor tjetër, gurthyesen me traj, transportierët shiritor, dhënësin vibrues, thërmuesen nofulllore, transportierin shiritor dhe në fund dhënësin vibrues. Te ndalesa e pajimeve të gurthyesit me seperacion në mënyrë automatike, pajimet ndalen me radhë në anën e kundërt të lëshimit të pajimeve duke filluar nga dhënësi vibrues e tutje. Te zgjedhja e punës në mënyrë manuale, pajimet lëshohen në punë secila në vete, përmes tastereve të veçanta, sipas zgjedhjes ton, gjithashtu edhe te komanda manuale duhet respektuar radhën, e lëshimit të pajimeve në punë, sikurse të mënyra automatike. Udhëheqja manuale preferohet vetëm në raste të defekteve, dhe në raste të remontit të pajimeve. Pajimet në gurthyes me seperacion aktivizohen me anë të energjisë elektrike ku pronari ka të ndërtuar trafon me mjete personale. Për realizimin e procesit teknologjik pronari ka në disponim edhe këto mjete të ngarkimit dhe transportit: dy kamionë me kapacitet $10m^3$, dy kamionë me kapacitet $20m^3$, dy ngarkues Ekskavator, dhe dy lopata ngarkuese. Renditja dhe lidhshmëria e pajimeve dhe stabilimenteve në mes veti të cilat nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror shihet në skemën teknologjike të paraqitur ne shtojcën 1 te Aplikacionit. Komponentët hyrëse në Kompaninë “XONI-H” Sh.p.k., Thermim dhe Seperim i gurit gëlqeror janë:
--	--	---

		• Energjia elektrike. • Uji • Nafta • Guri gelqeror Karburantet si lëndë djegëse nafta shërbenë për furnizimin e automjeteve transportuese dhe ngarkuese. Energjia elektrike shërben për ndriçim dhe funksionim të pajisjeve si dhe për nxehje. Furnizimi me energji elektrike bëhet nga rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike, nëpër mes trafostacionit që është pronë e kompanisë. Uji shfrytëzohet për qëllime sanitare, për sperkatjen e sipërfaqes operationale (gurthyes me seperacion), ujitjen e sipërfaqeve të gjelbruara. Nevojat e ujit për sanitari varet nga numri i punëtorëve p.sh për një punëtor nevojiten 25 lit. ujë/ditë. Furnizimi me ujë bëhet me cistern dhe nga rrjeti i ujësjellësit. Komponentët dalëse në procesin e thermimit dhe seperimit të gurit gëlqeror janë: • Avujt i hidrokarbureve dhe gazrat shkarkuese nga makinat transportuese. • Karburantet djegëse të lëngëta nafta • Ujërat e ndotura. • Zhurma. • Mbeturinat e ngurta.
--	--	---







3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	Hënë - Premte Orari i punës 08:00 – 17:00 E shtunë Orari i punës 08:00 - 14:00
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	Kapaciteti i planifikuar prodhues i masave të minuara është $Q = .000\text{m}^3/\text{vit}$, Kapaciteti i projektuar/realizuar ditor $Q = 33\text{m}^3 / \text{h} \times 8\text{h} = 264 \text{m}^3$ Kapaciteti i projektuar/realizuar mujor $Q = 33\text{m}^3/\text{dite} \times 25\text{dite} = 825 \text{m}^3$ Kapaciteti i projektuar/realizuar vjetor $Q = 16.000\text{m}^3/\text{muaj} \times 11 = 9075 \text{m}^3$.
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lëndëve ndihmëse.	• Agregatin (guri gëlqeror) • fraksionet +0-4mm; +4-8mm; +8-16mm; +16-32mm • Uji - kompania ka hapur një pus për furnizim me ujë, gjithashtu është i lidhur në rrjetin e ujësjellsit. • Energjia elektrike furnizohet me anë të trafos personale nga rrjeti elektrik i KEDS dhe e-Kes-Co.
3.1.6.	Lista e rezervuarëve dhe kapaciteti i tyre	Kompania “XONI-H” Sh.p.k., në zonën kadastrale Guriq, Malishevë, e cila si aktivitet ka thermimin dhe Seperimim e gurit gëlqeror nuk ka rezervuar për deponimin e naftës, apo kamion me cisternë për spërkatjen e sipërfaqeve manipuluese.
3.1.7.	Lista e legjislacionit në fuqi	Lista e Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative për kompletimin e kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore; Ligjet: 1. Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit 2. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) 3. Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor 4. Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet

		5. Ligji Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet 6. Ligji Nr. 03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës 7. Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim 8. Ligji Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore 9. Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës 10. Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës 11. Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rrugë Nr. 2003/11 12. Ligji Nr. 08/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikatet 13. Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja 14. Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina 15. Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma 16. Ligji Nr. 04/L-012 për Mbrojtjen nga Zjarri Udhëzimet Administrative; 1. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore 2. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore 3. Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2017 për Leje Mjedisore 4. Udhëzimi Administrativ (MMPH) Nr. 04/2018 për Pengimin e Aksidenteve të Mëdha ku përfshihen Substancat e Rrezikshme 5. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor
--	--	---

		6. Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes 7. Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave
--	--	--

3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit

3.2.1.	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	Kompania “XONI-H” Sh.p.k., e vendosur në zonën kadastrale Guriq, Malishevë, e cila ushtron aktivitetin e thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror, është e përkushtuar që përmes të gjitha funksioneve të saj organizative të sigurojë përmirësim të vazhdueshëm, duke përmblusur të gjitha detyrimet ligjore për ruajtjen e një mjedisi të pastër dhe të qëndrueshëm. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor, të bazuara në standardin ISO 14001, mundësojnë identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin efektiv të aspekteve mjedisore të një organizate, me qëllim: • përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore; • parandalimin e ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit; • respektimin e legjislacionit vendor në fuqi; • përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me autoritetet përkatëse.
3.2.2.	Raportimi	//

4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

4.1.	Pikat e burimit të emisioneve e materieve ndotëse	Gjatë funksionimit kontinuel të kompanisë “XONI-H” Sh.p.k., e vendosur në zonën kadastrale Guriq, Malishevë, e cila ushtron aktivitetin e thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror ndotja e ajrit vjen nga qarkullimet e automjeteve transportuese të gurit gëlqerorë. Gazrat nga djegëjet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NO_x, HxCy, SO₂ dhe Pb. Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike-meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin e kompleksit. • Pluhtrat të cilat lirohen gjatë separimit të fraksioneve në sitat vibruese. • Pluhtrat të cilat lirohen nga deponitë të cilat nevoiten për deponimin e fraksioneve të materialit të thërmuar. • Pluhtrat të cilat lirohen gjatë ngarkimit dhe transportimit të fraksioneve në automjetet transportuese. • Pluhtrat të cilat lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqeve operationale që ndodhen në afërsi të gurthyesit me separacion. • Ndotje e mjedisit ndodh nga pluhuri i cili emitohet gjatë punëve dhe aktiviteteve gjatë procesit të ngarkimit dhe shkarkimit, të gurit gëlqerorë, gjatë procesit të transportit, • Pluhuri i cili emitohet në momentin e thyerjes së masës së mëdhe të thermuesja primare me nofulla, sekondare, • Pluhtrat të cilat lirohen gjatë transportit të fraksioneve në të gjitha shiritat transportues.
------	---	---

		Duke i marruar parasysh përqendrimet e ndotësve të cilat emitohen në lokacionin e kompleksit për therrimin dhe seperimin e gurit gëlqeror mund të përfundohet se ndotja e ajrit është me përmasa relativisht nën përqendrimet e lejuara dhe janë lehtë të kontrollohen.
4.2	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Gjatë realizimit të procesit teknologjik të kompanisë “XONI-H Sh.p.k., e vendosur në zonën kadastrale Guriq, Malishevë, e cila ushtron aktivitetin e thërmimit dhe separimit të gurit gëlqeror ndikime negative në ajër ndodhin nga: • Pluhuri i cili lirohet çdo herë në momentin e thyerjes së masës, do të thotë të thërmuesja primare statike thërmuesja sekondare. • Pluhurat të cilët lirohen nga deponit të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të materialit. • Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të fraksioneve në të gjithë shiritat transportues. • Pluhurat të cilët lirohen nga mekanizmi ngarkues i fraksioneve në automjetet transportuese. • Pluhurat të cilët lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operationale që ndodhën në afërsi të gurëthyesit me seperacion. • Ndotja e ajrit ndodhë nga gazrat të cilët lirohen nga automjetet transportuese, që nevojiten për transportimin e fraksioneve të agregatit • Gazrat të cilat lirohen nga automjetet e transportit dhe ngarkimit. • Pluhurat të cilët lirohen gjatë seperimit të fraksioneve në sitat vibruese.

4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse paraqiten nga pluhurat të cilët lirohen nga qarkullimi i automjetet brenda dhe jashte kompleksit. Pluhurat të cilët lirohen nga deponit të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të agregatit, pluhurat të cilët lirohen nga shiritat transportues gjatë transportit të fraksioneve të agregatit lirim të pluhurit nga sipërfaqet manipuluese.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Masat e marrura për mbrojtjen e ajrit • Me qëllim të zvogëlimit të ndotjes së ajrit e cila ndodhë si rezultat i djegies së lëndëve djegëse janë siguruar kushtet për djegie (derivate) sa me kualitative për gjenerator dhe mjete tjera transportuese. • Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër gjatë fazës të zhvillimit të aktiviteteve të gurthyesit bëhet kontrollimi i rregullt teknik i makinave ngarkuese (pirunëve) dhe transportuese që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirim i gazrave nga automjetët e punës të jetë sa më kualitativ.
4.5.	Pajisjet për de-pluhurin	Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet negative në ajër gjatë funksionimit të kompanisë “XONI-H” Sh.p.k., e vendosur në zonën kadastrale Guriq, Malishevë, e cila ushtron aktivitetin e thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror, janë ndërmarrë këto masa: • Kryhet kontroll i rregullt i thasëve filtrues, ndërsa ata të dëmtuar zëvendësohen menjëherë. • Realizohet kontroll teknik periodik i makinave që përdorin lëndë djegëse të lëngëta, me qëllim minimizimin e emetimit të gazrave ndotës nga automjetet e punës.

		• E gjithë hapësira e kompleksit të gurthyesit spërkatet me ujë, veçanërisht gjatë periudhave me erëra dhe temperatura të larta, për të reduktuar përhapjen e pluhurit. • Kryhet mirëmbajtje e rregullt e pajisjeve për thërmimin dhe separimin e gurit gëlqeror, në veçanti e stabilimenteve që përbëjnë burim të emisioneve të pluhurit. • Sigurohet mirëmbajtje e vazhdueshme e sistemit të instaluar për reduktimin e pluhurit, i cili funksionon përmes spërkatjes me ujë dhe filtrimit të mëposhëm.
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Kompania “XONI-H” Sh.p.k., e vendosur në zonën kadastrale Guriq, Malishevë, e cila si aktivitet ka thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, nuk e bën monitorimi i emisioneve.
4.7.	Monitorimi i emisioneve/ cilësisë ë ajrit	Kompania “XONI-H” Sh.p.k., e vendosur në zonën kadastrale Guriq, Malishevë, e cila si aktivitet ka thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, nuk e bën monitorimi i emisioneve.
4.8.	Raportimet	//
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, rrugët ku realizohet transportimi i masës shkëmbor spërkatet vazhdimisht me ujë. Pluhuri që lirohet gjatë procesit teknologjik të thërmimit dhe separimit zvogëlohet deri në kufijtë e lejuar, duke mos paraqitur ndikime të konsiderueshme në mjedis. Për këtë qëllim, kompania ka instaluar një sistem ujqor për reduktimin e pluhurit. Furnizimi me ujë realizohet përmes cisternave dhe pompave, ndërsa uji transportohet përmes gypave deri te stabilimentet e gurthyesit me separacion. Sistemi i ujit është instaluar në të gjitha pikat ku gjenerohet pluhur, përfshirë: bunkerët pranues, gurthyesit, sitat vibruese dhe shiritat transportues. Sistemi është i pajisur me valvula për

		rregullimin mekanik të sasisë së ujit, si dhe me dizna që shpërndajnë ujin në formë mjegulle. Kjo mundëson lagje efektive të materialit dhe parandalon lirim të pluhurit gjatë përpunimit dhe transportit të fraksioneve. Sasia e ujit rregullohet në mënyrë optimale, vetëm sa për të mundësuar precipitimin e grimcave të pluhurit pa shkaktuar lagështi të tepërt. Kjo sasi varet nga lagështia natyrore e gurit gëlqeror që përpunohet. Në rastet kur sistemi ujor nuk arrin të reduktojë pluhurin në nivelet e lejuara, ndërmerren masa shtesë: - mbulimi i shiritave transportues, veçanërisht për fraksionet më të imëta; - vendosja e hinkave në pikat e shkarkimit të materialit; - ndërtimi i hapësirave të mbyllura për depozitimin e fraksioneve më të imëta, me qëllim parandalimin e shpërndarjes së pluhurit në atmosferë. Përshkrimi i procesit teknologjik të de-pluhurimit; Pluhuri i krijuar gjatë procesit teknologjik thithet nga stabilimentet përmes rrjedhës së ajrit, nëpërmjet gypave të instaluar në pikat ku gjenerohet pluhuri. Sasia e ajrit të thithur përcaktohet bazuar në përvojë dhe në matjet e kryera në pajisje përkatëse. Në çdo pikë janë instaluar flutura rregulluese për kontrollin e rrjedhës së ajrit. Gypat janë dimensionuar në mënyrë të tillë që shpejtësia e ajrit të jetë e mjaftueshme për të parandaluar depozitimin e pluhurit në brendësi të tyre. Të gjithë gypat janë të lidhur me gypin kryesor mbledhës, i cili është i lidhur me filtrin e tipit OVF-350. Në pikat lidhëse janë vendosur mbyllëse gome që sigurojnë izolim dhe shmangin humbjet e ajrit. Në filtrin e thatë me bezë realizohet ndarja e pluhurit nga ajri i ndotur, me një efikasitet
--	--	---

		mbi 99%, ndërsa koncentrimi i pluhurit në dalje është nën 50 mg/m³. Filtri është i pajisur me sistem për pastrimin automatik të thasëve filtrues, i cili funksionon me ventilator për fryrje me ajër në presion. Ky sistem kontrollohet përmes releve kohore që rregullojnë ciklet e pastrimit. Ajri i pastruar kalon në ventilatorin kryesor dhe më pas në oxhak nga ku lirohet në atmosferë. Pluhuri i ndarë transportohet përmes kërmillit në transporter pneumatik dhe më pas në silos. Silosi është i pajisur me nivelmatës për kontrollin e kapacitetit maksimal, ndërsa zbrazja realizohet përmes sistemit mekanik në autocisterna. Për shmangien e grumbullimit të pluhurit në pjesët konike përdoret ajër i komprimuar. Pajisjet për de-pluhurim përbëhen nga: - filtri OVF-350 me bezë të thatë; - ventilatori centrifugal; - gypat, lidhëset, reduktorët, fluturat rregulluese dhe oxhaku; - transporteri pneumatik; - silosi. Pikat kryesore të gjenerimit dhe trajtimit të pluhurit: Thërmuesja; Hinkat e pranimi të materialit; Sitat vibruese; Shiritat transportues.
4.10.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	Kompania “XONI-H” Sh.p.k., e vendosur në zonën kadastrale Guriq, Malishevë, e cila si aktivitet ka thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror ka marrë masat për: Përdorimin e makinerive dhe pajisjeve me teknologji të reja dhe konsum të ulët karburanti.

		• Bëhet mirëmbajtja periodike e makinerive për të siguruar djegie efikase të karburantit dhe ulje të emetimeve. • Përdorimin e ndriçimit me LED në zonat e shërbimit. Reduktimi i Pluhurit dhe Gazrave • Posedon sisteme spërkatjeje me ujë dhe filtra për uljen e emetimeve në ajër. • Rrugë të shtruara me inerte për të reduktuar pluhurin nga qarkullimi i mjeteve. • Transporti i materialit të imët me mbulesa për të shmangur shpërndarjen e pluhurit. Optimizimi i Transportit • Organizim i rrugëve të brendshme të qarkullimit për të ulur konsumin e karburantit. • Përdorimi i mjeteve të pajisura me motorë më të rinj (Euro 5/6). • Planifikim i ngarkesave për të zvogëluar numrin e udhëtimeve. Rekomandohet përdorimi i Energjive të Rinovueshme; • Instalimi i paneleve diellore fotovoltaike për ndriçim ose për furnizim të pjesshëm të makinerive ndihmëse. • Përdorimi i burimeve alternative të energjisë për pajisjet ndihmëse. Rekultivimi dhe Gjelbërimi • Mbjellja e pemëve dhe gjelbërimit përreth zonës së impiantit, duke ndihmuar në absorbimin e CO₂. • Përdorimi i zonave të rikultivuara si buffer natyror për zbutjen e ndikimit vizual dhe thithjen e ndotësve. Menaxhimi i Mbetjeve • Riciklimi i materialit të imët dhe përdorimi i mbetjeve inerte për rikultivim.
--	--	--

		• Ndërprerja e djegies së mbetjeve në ambient të hapur (praktikë e ndaluar).
--	--	--

5. UJI		
5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Kompania “XONI-H” Sh.p.k., e vendosur në zonën kadastrale Guriq, Malishevë, e cila si aktivitet ka thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, ujin për shfrytëzim e merr me cisterna dhe nga ujësjellësi dhe shfrytëzohet për nevojat e këtij aktiviteti; kryesisht për depluhrim dhe sperkatje, gjithashtu edhe për nevoja higjenike.
